



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 517/10 prot.

Datë 09.03.2026

V E N D I M
Nr. 366/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 09.03.2026 shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 309/2026, datë 25.02.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-76139-02-13-2026, me objekt “Blerje makinerish (ekskavator dhe miniekavator)”, me fond limit 13.968.817 (trembëdhjet million e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 03.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.a
- Ankimues:** Operatori ekonomik “InAuto” SHPK, me Nipt. M31417021V dhe adresë Njësia Administrative Nr. 11, Rruga “Gjoke Doci”, Numri i pasurisë 630/449, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.a Rajoni Nr.1, Rruga: “Boris Plumbi”, Nr. 20, Korçë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 25.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 309/2026, ku vendosi:

“[...]

- 1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “InAuto” SHPK për procedurën e prokurimit “Proçedurë e hapur”, me nr. REF-76139-02-13-2026, me objekt “Blerje makinerish (ekskavator dhe miniekskavator)”, me fond limit 13.968.817 (trembëdhjet million e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 03.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.a.*
- 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE, sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “InAuto” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë [...]”

I.2. Me shkresën nr. 306/29 prot., me objekt “Shkresë përcjellëse”, protokolluar me tonën nr. 517/7 prot., datë 03.03.2026, autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.a., njofton se ka zbatuar vendimin Nr.309/2026, datë 25.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 306/29 prot., me objekt “Shkresë përcjellëse”, protokolluar me tonën nr. 517/7 prot., datë 03.03.2026, autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime

Korçë Sh.a., njofton se ka zbatuar vendimin Nr.309/2026, datë 25.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se shtojca është publikuar në SPE.

Nga verifikimet në shtojcën e dërguar nga autoriteti kontraktor dhe publikuar në SPE, konstatohet se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e KPP Nr. 309/2026, datë 25.02.2026.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a e ka zbatuar vendimin vendimin Nr. 309/2026, datë 25.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-76139-02-13-2026, me objekt “Blerje makinerish (ekskavator dhe miniekskavator)”, me fond limit 13.968.817 (trembëdhjet million e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 03.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

